



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 513 Prot.

Tiranë, më 21.01. 2025

U D H Ë Z I M

Nr. 5, Datë 21.01. 2025

PËR

DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar”,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:
 - a) Pikat 1, 2, 6, 8 dhe 10 të kreut III ndryshojnë si më poshtë:

“1. Regjistrimi fillestar i formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuar nga IAL, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit të IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

2. Aplikimi për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës shqyrtohet nga QShA. Formulari për regjistrimin e formës së diplomës, i nënshkruar prej rektorit të IAL-së, shoqërohet me:

- a) Vendimin e Senatit Akademik, shoqëruar me formën e miratuar të diplomës apo certifikatës që do të regjistrohet, si dhe suplementin e diplomës (nëse ka);
- b) Mandat pagesën për tarifën e regjistrimit në regjistrin shtetëror.

QShA siguron nëpërmjet ndërveprimit me institucionet përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kopjen e statutit të IAL-së të miratuar dhe aktin e miratimit të tij.
- b) Kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së ose kur afati i akreditimit ka përfunduar, kopjen e dokumentit, me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik institucional.
- c) Kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma, që regjistrohet dhe kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma që regjistrohet, ose kopjen e dokumentit me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik të programit të studimit, me përjashtim të programit të studimit për të cilin legjislacioni në fuqi nuk parashikon akreditimin e tij.

...

6. QShA-ja kryen regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës në Regjistrin shtetëror dhe lëshon vërtetimin përkatës me vulë elektronike për IAL-në. Ky vërtetim i dërgohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

...

8. Në rast se pas verifikimeve, rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrim, të parashikuara në këtë udhëzim, QShA-ja pezullon aplikimin dhe njofton IAL-në në portalin unik qeveritar e-Albania, për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Afati i procedurës së regjistrimit rifillon ditën pasardhëse të plotësimit ose ndreqjes së këtyre elementëve, në portalin unik qeveritar e-Albania.

...

10. Refuzimi i aplikimit, i cili përmban shkakun e refuzimit, i njoftohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.”.

b) Pas pikës 1, të kreut IV shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

